



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2021
Nr. Ref.:RK 1744/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI97/20

Parashtrues

Nehat Salihu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
ARJ. UZVP. nr. 140/2019, të 19 nëntorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Nehat Salihu, me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin ARJ. UZVP. nr. 140/2019, të 19 nëntorit 2019, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme). Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 22 maj 2020.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), pretendon se i janë cenuar përmes Aktgjykimit të kontestuar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale], të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 qershor 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën e kishte dorëzuar me postë më 13 qershor 2020.
6. Më 23 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 6 korrik 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK). Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për çështje administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), kërkesën që të dorëzojë fletëkthesën e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
8. Më 7 korrik 2020, Gjykata Themelore e dorëzoi fletëkthesën e kërkuar e cila dëshmon që parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 22 maj 2020.
9. Më 21 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
10. Më 26 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 26 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës ishte emëruar në pozitën e drejtorit të Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë “Arbëria”, në Gjiilan. Para emërimit të tij në pozitën e drejtorit, parashtruesi i kërkesës kishte qenë mësimpldhënës në po të njëjtën shkollë.
12. Më 16 mars 2015, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Gjilanit kishte iniciuar procedurë disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit se i njëjti kishte kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës nga neni 6 (Shkeljet e rënda-serioze) paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.10 dhe 1.15, të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil (në tekstin e mëtejme: Rregullorja për Procedurat Disiplinore), përkatësisht nuk kishte raportuar në Drejtorinë e Arsimit në Gjiilan mungesën e mësimpldhënësit të Edukatës Fizike nga 28 tetori 2014 deri më 2 mars 2015, si dhe mungesën e mësimpldhënësve të tjerë në procesin mësimplor dhe nuk kishte ndërmarrë veprime në rritjen e kontrollit të brendshëm për të realizuar krijimin e të hyrave nga shitja e produkteve të prodhuara.
13. Më 18 mars 2015, përmes Aktvendimit 02-16-2839 të Udhëheqësit të Njësisë së Personelit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Gjilanit, parashtruesi i kërkesës u pezullua nga puna me pagesë deri në tre (3) muaj (duke filluar nga data 18 mars 2015), në pritje të një hetimi për shkak të dyshimit se i njëjti kishte kryer shkelje serioze të Kodit të Mirësjelljes, siç është përcaktuar me nenin 6, paragrafin 1, nënparagrafët 1.4, 1.10 dhe 1.15, të Rregullores për Procedurat Disiplinore.
14. Më 14 prill 2015, Komisioni Disiplinor në kuadër të Komunës së Gjilanit, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, nxori Vendimin 02-016-35902, përmes të cilit parashtruesin e kërkesës e shpalli përgjegjës për shkelje serioze të detyrave të punës dhe i shqiptoi masën disiplinore *“ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të Komunës.”* Përmes të njëjtit Vendim u shfuqizua edhe Aktvendimi 02-16-2839, i 18 marsit 2015, i Udhëheqësit të Njësisë së Personelit për pezullimin e përkohshëm nga puna me pagesë.
15. Më 28 prill 2015, parashtruesi i kërkesës në Drejtorinë Komunale kishte paraqitur kërkesë për kthimin e tij në vendin e punës si mësimpldhënës.
16. Më 5 maj 2015, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë kundër Vendimit të lartcekur të Komisionit Disiplinor, në Komisionin Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjilanit (në tekstin e mëtejme: Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave).
17. Më 22 maj 2015, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, përmes Vendimit 02-016-42542/2 e miratoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vendosur që masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës ta zëvendësojë me masën transferim në detyra të tjera si mësimpldhënës, me ndalim gradimi për pesë (5) vjet.

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesë parashtroi ankesë në KPMSHCK, kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, 02-016-42542/2, të 22 majit 2015.
19. Më 27 korrik 2015, KPMSHCK, përmes Vendimit A/02/320/2015: (i) shfuqizoi Vendimin 02-016-42542/2, të 22 majit 2015, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjilanit; (ii) obligoi Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjilanit që brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Vendimit, të bëj rishqyrtimin e ankesës së 5 majit 2015; (iii) obligoi Kryetarin e Komunës që të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi; dhe (iv) urdhëroi që KPMSHCK të njoftohet për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në pajtim me këtë Vendim.
20. Në vendimin e vet, KPMSHCK konstatoi se: *“Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk mund të bëjë ndryshimin apo zëvendësimin e masës disiplinore por duhet të vendosë për ligjshmërinë e vendimeve paraprahe të atij organi në këtë rast për vendimin e Komisionit Disiplinor, dhe të njëjtën kohë duhet të vendosë të refuzojë ankesën ose të aprovojë të njëjtën, në pajtim me dispozitat e nenit 9, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe ankesave ku përcaktohet se “Komisioni i shqyrton dëshmitë e siguruara dhe në bazë të tyre vendosë se a pranohet ankesa apo jo”.*
21. Më 17 gusht 2015, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, përmes Vendimit 02-016-42542/02, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi që Vendimi i Komisionit Disiplinor nr. 02/016/35902, i 14 prillit 2015, përmes të cilit parashtruesit të kërkesës i ishte shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës të mbetet në fuqi.
22. Më 7 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në KPMSHCK, kundër Vendimit 02-016-42542/02, të 14 gushtit 2015, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjilanit, përmes të cilës kërkoi që të kthehet në pozitën e drejtorit të shkollës, ose të kthehet në pozitën e mëparshme të mësimdhënësit, para emërimit të tij në pozitën e drejtorit.
23. Më 26 tetor 2015, KPMSHCK, përmes Vendimit A/02/432/2015, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi që të mbetet në fuqi Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjilanit, 02-016-42542/02, i 17 gushtit 2015.
24. KPMSHCK, përmes Vendimit të lartcekur, konstatoi se parashtruesi i kërkesës ka kryer shkelje disiplinore ashtu siç është përcaktuar me nenin 6 paragrafin 1, nënparagrafët 1.4, 1.10 dhe 1.15 të Rregullores për Procedurat Disiplinore dhe, po ashtu, ka shkelur dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 5 (Parimet themelore të shërbimit civil), paragrafët 1.1 [Ligjshmëria], 1.4 [Efektshmëria dhe efikasiteti], 1.5 [Përgjegjësia] dhe 1.6 [Paanësia dhe pavarësia profesionale], dhe nenet 51, (Ushtrimi i detyrës dhe detyrimi për zbatimin e ligjit), 52 (Detyrimi për mos shpërdorimin e autoritetit), 55 (Detyrimi për informim dhe arsyetim të veprimeve administrative) dhe 64 (Përgjegjësia Disiplinore).

25. Ndërsa sa i përket kërkesës së tij për kthimin e tij në pozitën e mëparshme të mësimdhënësit, para emërimit të tij në pozitën e drejtorit, KPMSHCK konstatoi se nuk është kompetent për vendosjen përkitazi me këtë kërkesë, përkatësisht *“Këshilli nuk mund të vendosë për marrëdhëniet e punës së stafit mësimor pasi që kjo kategori e punonjësve publik nuk e ka statusin e shërbyesve civilë”*.
26. Në bazë të shkresave të lëndës vërehet se parashtruesi i kërkesës në bazë të një kopje të një kërkesë të 23 nëntorit 2015, drejtuar Kuvendit Komunal të Komunës së Gjilanit dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit (e cila nuk është e protokolar se është pranuar nga këto të fundit), kishte kërkuar si në vijim: *“ kërkoj nga Inspekcioni i punës të shyrton kërkesën e Nehat Salihut për rikthimin në vendin e punës si profesor në shkollën e mesme të Bujqësisë, pasi që këshilli i pavarur mbikqyrës në Prishtinë ka kthyer vendimin të cilin nuk mundet ta vendosë lidhur për kthimin në vendin e punës si profesor ku sipas shkresës nuk është kompetencë e këshillit të pavarur që të vendos për kategorinë e këtyre punonësve para mësimdhënësve”*.
27. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, përmes së cilës kërkoi që të anulohet Vendimi i KPMSHCK, A/02/432/2015, i 26 tetorit 2015, në mënyrë që të kthehet në pozitën e drejtorit të shkollës, ose të kthehet në pozitën e mëparshme të mësimdhënësit, para emërimit të tij në pozitën e drejtorit.
28. Më 11 qershor 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit A. nr. 1998/15, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
29. Gjykata Themelore, në Aktgjykimin e saj përkitazi me kërkesën e parashtruesit për kthimin e tij në pozitën e drejtorit të shkollës, gjeti se parashtruesi i kërkesës *“[...] nuk ka ushtruar kontroll të duhur sa i përket mungesave të shumta të personelit edukativo-arsimor, duke mos marrë asnjë njoftim për ta njoftuar Drejtorinë Komunale të Arsimit, si dhe duke mos e paraqitur rastin për mësimdhënësin e Edukatës Fizike në atë shkollë i cili ka munguar nga puna nga data 28.10.2014 deri më datë 02.03.2015, dhe i njëjti ka vazhduar të marrë pagën mujore edhe gjatë këtyre muajve, duke bërë shkelje të detyrave të punës dhe dëmtimin e pronës institucionale. Për më tutje, paditësi i ka shkaktuar dëm institucionit për shkak të neglizhencës ose dështimit të ushtrimit të funksionit të tij duke kryer shkelje të sanksionuara me nenin 6 paragrafin 1 nën-paragrafi 1.4,1.7,1.10 dhe 1.14 të Rregullores nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil”*.
30. Ndërsa sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës për kthimin në vendin e punës si mësimdhënës para emërimit të tij si drejtor i shkollës, Gjykata Themelore theksoi se KPMSHCK me të drejtë ka konstatuar se nuk është kompetent për të vendosur për marrëdhënien e stafit mësimor pasi që kjo kategori e punonjësve publikë nuk e ka statusin e shërbyesve civil.
31. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

32. Më 20 shtator 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AA.nr. 469/2018, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, A. nr. 1998/15, të 11 qershorit 2018.
33. Gjykata e Apelit konstatoi se aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte i bazuar në ligj, përkatësisht në dispozitat e Ligjit për Shërbyesit Civil dhe nuk ishte i përfshirë në shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata e Apelit gjeti se Gjykata Themelore më të drejtë ka konstatuar se KPMSHCK nuk është kompetent për çështjen e ndërprerjes së marrëdhënies së punës si mësimdhënës, për arsye se kjo çështje rregullohet me Ligjin e Punës, pasi që mësimdhënësit nuk hyn në kategorinë e shërbyesve civilë.
34. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr. 469/2018, të 20 shtatorit 2019, me pretendimin se ai është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
35. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit ARJ-UZVP nr. 140/2019, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
36. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit për kthimin në pozitën e drejtorit të shkollës, Gjykata Supreme konstatoi se gjykatat e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë, respektivisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi për Shërbyesit Civil. Kjo si rezultat i mosparaqitjes apo moslajmërimit të mungesës së mësimdhënësit të Edukatës Fizike, nga 28 tetori 2014 deri më 2 mars 2015, në Drejtorinë Komunale për Arsim në Gjilan, si dhe moslajmërimit të mungesave të mësimdhënësve të tjerë në orët e mësimi.
37. Ndërsa përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës si mësimdhënës, Gjykata Supreme konstatoi se *"[...] KPMSHC nuk është kompetente për të vendosur për marrëdhëniet e punës për stafin mësimor të sistemit arsimor sepse të njëjtit nuk janë shërbyes civilë dhe nuk ka kompetencë të vlerësojë kthimi e paditësit në pozitën e drejtorit, e që ka vlerësuar se kjo çështje është përcaktuar me nenin 9 të Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, ku përcakton se kandidatëve të cilëve u ka përfunduar ose u është ndërprerë mandati i drejtorit/zëvendësdrejtorit në institucionet edukativo-arsimore, të cilat në këto mandate kanë ardhur nga institucionet edukativo-arsimore, u ruhet vendi në këto institucione. Në rastin konkret me vendimin e KPMSHCK për pjesën sa i përket ndërprerjes së marrëdhënies së punës si mësimdhënës me të drejtë e ka shpallur vetën jokompetente".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur në mënyrë specifike ndonjë të drejtë të garantuar me Kushtetutë, për të cilën ai pretendon se i është shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ARJ. UZVP. nr. 140/2019, të 19 nëntorit 2019.
39. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të dispozitave të paspecifikuara të Ligjit për Shërbyesit Civil në Republikën e Kosovës, Ligjit të Punës dhe Udhëzimit Administrativ 08/14, të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi i MASHT-it).
40. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij kërkon vlerësimin e *“ligjshmërisë së vendimeve, dhe Aktgjykimeve të Institucioneve Shtetërore e Gjyqësore të Kosovës”*.
41. Parashtruesi i kërkesës pohon se: *“Suspendimi im ka qene me qellim tendecioze dhe hakmarrëse, per qeshtje politike dhe me qellim të plotësimit të kësaj pozite me militant partiak e qellim të ndryshme familjare”*.
42. Tutje, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij thekson si në vijim:

“Nuk janë zbatuar ligjërisht dispozitat ligjore nga Ligji mbi shërbimin civil, Udhëzimi Administrativ i MASHT 08/2014 si dhe Ligji i Punës. Aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë.”

43. Në vijim, parashtruesi i kërkesës specifikon se *“NUK është shqyrtuar mundësia e zbatimit të vendimit të Inspektoratit të punës, për kthimin, sistematizimin në pozitën e profesorit të Bujqësisë. Jane bere shkelje substanciale të dispozitave ligjore, diskriminuese dhe jane politikisht të motivuara nga Elita Politike e Komunes se Gjilanit. Vendimet e Komunes jane të politizuara dhe me qellime tendencioze e politike”*.
44. Parashtruesi i kërkesës, pasi ka pasqyruar kronologjinë e procedurave të ndjekura para autoriteteve publike, gjegjësisht organeve të Komunës së Gjilanit, KPMSHCK-së dhe gjykatave të rregullta, i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

“Andaj nga te cekurat me lart, ju lus të ngritni zërin e arsyes dhe [kundër] diskriminimeve të cilat janë duke u bere të punësuarve në të gjitha Institucionet Shtetërore. Anulimin e tyre dhe detyrimin e organeve që të rishqyrtojnë e vlerësojnë ligjërisht, Vendimet e Aktgjykimet e atakuara.”
45. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *“Kthimin në pozitën e punës të Profesorit të Bujqësisë pas shkarkimit nga Pozita e Drejtorit”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

48. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

49. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 39 (1) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.”

50. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se: (i) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është marrë me shkelje të dispozitave të paspecifikuara të Ligjit për Shërbyesit Civil në Republikën e Kosovës, Ligjin e Punës dhe të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe, (ii) në rastin e tij *“NUK është shqyrtuar mundësia e zbatimit të vendimit të Inspektoratit të punës, për kthimin, sistematizimin në pozitën e profesorit të Bujqesise”*. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij para Gjykatës, shprehimisht kërkon kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës si mësimdhënës.
51. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit që kanë të bëjnë me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ARJ. UZVP. nr. 140/2019, të 19 nëntorit 2019, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimit ARJ. UZVP. nr. 140/2019, të 19 nëntorit 2019, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesit të kërkesës përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
52. Më tutje, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me ligj, Gjykata duhet t'i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parashtruesve të kërkesave kushtetuese ua përcakton detyrimin që në kërkesat tyre drejtuar Gjykatës Kushtetuese të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar.
53. I njëjti kriter është i përcaktuar qartë edhe në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] paragrafin (1) pika (d), të Rregullores së punës, i cili kërkon që kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

54. Në këtë sfond, Gjykata thekson se për të konsideruar që një kërkesë plotëson kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi i kërkesës është i detyruar që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri, të garantuara me Kushtetutë, i janë cenuar dhe në mënyrë adekuate të paraqesë faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih në këtë kontekst rastet KI91/17, parashtrues *Enver Islami*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 31 dhe KI206/19, parashtrues *Mladen Nikolić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shkurtit 2019, paragrafi 33).
55. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon shkelje të dispozitave të paspecifikuara të Ligjit për Shërbyesit Civil në Republikën e Kosovës, Ligjin e Punës dhe të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar se cilat të drejta dhe liri, të garantuara me Kushtetutë, pretendon se i janë cenuar përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
56. Gjykata rikujton se Komisioni Disiplinor, përmes Vendimit 02 016-35902, të 14 prillit 2015, parashtruesit të kërkesës ia kishte ndërprerë marrëdhënien e tij të punës në shërbimin civil, gjegjësisht e kishte larguar nga pozita e drejtorit të shkollës. Kjo si rezultat i konstatimit nga ana e Komisionit në fjalë se parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje disiplinore, të përcaktuara me Rregulloren për Procedurat Disiplinore. Vendimi i Komisionit Disiplinor ishte konfirmuar nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, KPMSHCK, Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe në fund edhe nga Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të kontestuar. Përderisa, përkitazi me kërkesën e tij për kthimin në vendin e tij të punës si mësimdhënës para emërimit të tij në pozitën e drejtorit, e cila kërkesë bazohej në nenin 9 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, KPMSHCK dhe gjykatat e rregullta kishin konstatuar se KPMSHCK nuk është kompetent për të vendosur përkitazi me marrëdhënien e stafit mësimor, pasi që kjo kategori e punonjësve publikë nuk e ka statusin e shërbyesve civil.
57. Gjykata vë në dukje se parashtruesi i kërkesës i konteston gjetjet dhe konstatimet e lartcekura të autoriteteve publike, gjegjësisht gjykatave të rregullta. Megjithatë, parashtruesi nuk ka qartësuar se cilat të drejta dhe liri, të garantuara me Kushtetutë, pretendon se i janë cenuar përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të cilin ai e konteston në Gjykatë. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk qartëson saktësisht faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese.
58. Pra, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ngritë pretendime të përgjithësuara që kanë të bëjnë me mënyrën se si institucionet përkatëse dhe gjykatat, që kanë vendosur në rastin e tij, kanë bërë zbatimin e Ligjit për Shërbyesit Civil, Ligjit të Punës dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, 08/2014. Por, Gjykata thekson se vetëm ngritja e pretendimeve të tilla të përgjithësuara, pa saktësuar të drejtat kushtetuese të cilat parashtruesi pretendon se i janë cenuar dhe pa qartësuar faktet që arsyetojnë këtë pretendim, nuk është e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e nenit 48 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

59. Përkitazi me pretendimin tjetër të parashtruesit të kërkesës, se “*nuk është shqyrtuar zbatimi i Vendimi i Inspektoratit të Punës për kthimin e tij në pozitën e mësimdhënësit*”, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës fillimisht nuk specifikon se cili autoritet nuk ka zbatuar Vendimin e paspecifikuar të Inspektoratit të Punës. Në bazë të shkresave të lëndës vërehet se parashtruesi në Gjykatë ka dorëzuar vetëm kopjen e një kërkesë, që mban datën e 23 nëntorit 2015, drejtuar Kuvendit Komunal të Komunës së Gjilanit dhe Drejtorisë së Arsimit, përmes të cilës kërkon nga Inspektorati i Punës kthimin e tij në pozitën e mëhershme si mësimdhënës. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë Vendim të Inspektoratit të Punës, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se është nxjerrë në rastin e tij dhe po ashtu nuk ka specifikuar se ka ndërmarrë edhe veprime të tjera procedurale për zbatimin e Vendimit të pretenduar të Inspektoratit të Punës, gjegjësisht nuk ka specifikuar se ka shteruar të gjitha mjetet juridike përkitazi me kërkesën e tij për kthimin e tij në pozitën e mësimdhënësit.
60. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ngritë këtë pretendim, lidhur me Vendimin e paspecifikuar të Inspektoratit të Punës për kthimin e tij në vendin e punës si mësimdhënës, para Gjykatës Kushtetuese pa i shteruar të gjitha mjetet efektive të parapara në legjislacionin përkatës.
61. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese, që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
62. Në këtë mënyrë, duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t’u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljet e pretenduara (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI43/20, parashtrues, *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafi 13, si dhe rastin e Gjykatës KI19/20, parashtrues, *Lutfi Shantir*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2020, paragrafi 36; shih, gjithashtu, rastin e GJEDNJ *Aksoy kundër Turqisë*, Aktgjykimit i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
63. Rrjedhimisht, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata bazuar në nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për moszbatim të Vendimit të paspecifikuar të Inspektoratit të Punës për kthimin e tij në pozitën e mësimdhënësit, është i papranueshëm si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike.
64. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se: (i) sa i përket Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, ARJ. UZVP. nr. 140/2019, të 19 nëntorit 2019, kërkesa është e papranueshme, sepse nuk janë plotësuar kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës; dhe (ii) sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës

për moszbatim të “Vendimit të paspecifikuar të Inspektoratit të Punës”, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, ashtu siç është përcaktuar me nenin 47 të Ligjit dhe pikën (b), të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullit 39 1 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 26 mars 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi